

**STATUT I SHOQERISE  
"INN COMPANY" Sh.P.K.**



*Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.*

Sot, me 24.Gusht 2018, personat e mëposhtem:

1-**Shoqeria "BRILANT HOTEL&SPA" Sh.p.k**, shoqeri me përgjegjesi të kufizuar e se drejtes shqiptare, regjistruar në regjistrin tregtar me NIPT L73611802A, me adresë Qerret, Fshati Qerret, Rruga Henz, pallat 5-katesh, kati 1, Nr.Pasurie 16/44-N1, zona kadastrale Nr.3101, Kavaje, përfaqësuar nga administratorja **Znj. Nertila Dulla**, e bija e Xhevdet, lindur me 02.01.1987, në Kavaje, Durres e banuese në Qerret, Kavaje, mbajtëse e letërnjoftimit ID me nr personal. I75102041F, madhore e me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar;

2-**Shoqeria "INTOURS ALBANIA" Sh.p.k**, shoqeri me përgjegjesi të kufizuar e se drejtes shqiptare, regjistruar në regjistrin tregtar me NIPT L31526002Q, me adresë TIRANE, Tirane, Bulevardi "Bajram Curri", Qendra Tregtare ETC, Shkalla 1, Apartamenti 11/1, përfaqësuar nga administratori **Z. Astrit Kurti** shtetas malazez lindur me 14.06.1978 në BAR, mbajtës i pasaportes me nr. K26PL4221 dhe nr. Personal 1406978223028 madhor e me zotësi të plote juridike e për të vepruar;

3- **Shoqeria "HARMONIA HOTELS GROUP" Sh.p.k**, shoqeri me përgjegjesi të kufizuar e se drejtes shqiptare, regjistruar në regjistrin tregtar me NIPT L22617801P, me adresë Tirane Golem Golem Rruga "Kompleksit", Rruga dytesore Plepa-Golem, KM 3,2504 Golem, Kavaje, përfaqësuar nga administratori **Z. Muhamed Kurmemi**, shtetas malazez, lindur me 10.02.1986 në BAR mbajtës i pasaportes me nr. E81EK2583 dhe nr. Personal 1002986220026 madhor e me zotësi të plote juridike e për të vepruar;

në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratuar këtu Statut si vijon:

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- "Statuti" është ky Statut i Shoqërisë;

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 24.08.2018, në, themeluesit e mësipërm, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar "INN COMPANY" SH.P.K.

**Neni 2  
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Sherbime hotelerie, bar, kafe, restorante, pishina, hapsira plazhi privat dhe sherbime turistike te te gjitha llojeve perfshi orgnaizim ekskursionesh. Import - eksport, tregtim me shumice dhe pakice,. Cdo transakcion tregtar ne lidhje me pasurite e luajteshme dhe paluajteshme, shitje, blerje pjesmarrjesh ne shoqeri, dege, konsurciume ose ente te tjera, garantimi dhe vendosja e barreve (mbi pasuri te luajteshme ose te paluajteshme), si dhe lidhja e cdo marreveshje financiare. Ofrimi i Sherbimeve keshilluese, zhvillim i studimeve kerkimore te tregut, krijimi i patentave dhe i markave tregtare si edhe te drejta te tjetra te pronesisë intelektuale, themelimi dhe organizimi i rrjeteve tregtare, lidhja e marreveshjeve te agjencise dhe te sherbimit, rezervime dhe shitje online.

### **Neni 3 Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e *pacaktuar dhe/ose e pakufizuar*.

### **Neni 4 Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën; Qerret, Fshati Qerret, Rruga Henz, pallat 5-katesh, kati 1, Nr.Pasurie 16/44-N1, zona kadastrale Nr.3101

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

### **Kreu II Kapitali**

#### **Neni 5 Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është LEKE 3.000.000 (tre milion leke). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **“BRILANT HOTEL&SPA” Sh.p.k me administratore Nertila Dulla** : Zoteruese e **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme LEKE 750.000 që përben **25% të kapitalit themeltar të shoqërisë**.
2. Ortaku themelues **“INTOURS ALBANIA” Sh.p.k me administrator Astrit Kurti** Zoteruese e **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme LEKE 750.000 që përben **25% të kapitalit themeltar të shoqërisë**.
3. Ortaku themelues **“HARMONIA HOTELS GROUP” Sh.p.k me administrator Muhamed Kurmemi** Zoteruese e **2 (dy) kuote** me vlerë të përgjithshme LEKE 1.500.000 që përben **50% të kapitalit themeltar të shoqërisë**.
4. Kontributi i ortakëve është në para dhe do të shlyhet prej tyre menjëherë me themelimin e shoqërisë. Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

#### **Neni 6 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**



Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## **Neni 7** **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Ne rast te shitjes se kuotave palte do te njofojne njera tjetren me ane te adresave te tyre elektronike ose nepermjet postes. Me kalimin e 30 diteve nga njoftimi fillestar palet kane te drejte ti drejtohen paleve te treta per shitjen.

Prioritet ne shitjen e kuotave te shoqërisë janë ortakët e shoqërisë, ne qofte se ato nuk kthejne pergjigje brenda 30 diteve nga momenti i lajmerimit nga ortaku qe deshiron te largohet nepermjet postes elektronike, atehere ai mund tja transferoje kapitalin e tije nje te treti.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III** **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

### **Neni 8** **Organi Vendimarrës**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqërisë qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 9**

#### **Mënyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 10**

#### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 11**

#### **Marrja e vendimeve**


Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të



4

politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.  
Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.



## Neni 12

### Përfshirja nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 13

### Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë për një mandat të plotë 5 (pesë) vjeçar emërimi:

**Z. Elton Dulla**, shtetas shqiptar, i biri i Fadil, lindur me 15.09.1984 në Kavajë, Durrës, banues në Qerret, Kavajë, mbajtes i leternjoftimit ID me nr. 028346281 dhe nr. personal I40915049H, madhor me zotesi të plote juridike e për të vepruar; *pa kufizime në kompetencat e administrimit.*

## Neni 14

### Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 15

### Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim a mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme: u kthen ortakëve kontributet; u paguan ortakëve interesa apo dividendë; u shpërndan

aktivet shoqërisë; lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV** **Viti financiar-ekspertet**

##### **Neni 16** **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 01. Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 17** **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per atë per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

#### **Kreu V** **Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë**

##### **Neni 18** **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të Asamblese se Ortakeve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës.

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqëri ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në kete statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


*Ky akt, u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua, nga ortakët themelues të shoqërisë.*

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“INN COMPANY” Sh.P.K.**

**“BRILANT HOTEL&SPA” Sh.p.k**  
*Perfaqesuar nga administratorja*  
**Nertila Dulla**

*Nertila Dulla*  


**“INTOURS ALBANIA” Sh.p.k**  
*Perfaqesuar nga administratori*  
**Astrit Kurti**

*Astrit Kurti*  


**“HARMONIA HOTELS GROUP” Sh.p.k.**  
*Perfaqesuar nga administratori*  
**Muhamed Kurmemi**

*MUHAMED KURMEMI*  
